



Instituti i Kosovës për Drejtësi

Analizë e shkurtë:
Nr. 04/2017 - IKD

LOJA E KUNDËRLIGJSHME E KRYEMINISTRIT ME PAGAT

(Analizë e shkurtër ligjore e vendimit të kundërligjshëm të Qeverisë Haradinaj për pagat, ndikimet financiare dhe pabarazia e pushteteve)

Prishtinë, dhjetor 2017

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Ky raport nuk paraqet domosdoshmërisht qëndrimet e donatorit.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Përkrahur nga:



British Embassy
Pristina



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Dhjetor 2017

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

I.	Përmbledhje ekzekutive.....	4
II.	Vendimi i kundërligjshëm i Qeverisë Haradinaj për rritjen e pagave të pushtetit ekzekutiv..	6
III.	Ndikimi financiar i Vendimit të Qeverisë Haradinaj në sistemin gjyqësor dhe prokurorial	8
IV.	Rekomandime	12

I. Përmbledhje ekzekutive

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) reagon ndaj Vendimit Nr. 4/20, të Qeverisë Haradinaj të miratuar më 20 dhjetor 2017 për ngritjen e mirëqenies ekonomike të një kategorie të pozitave të kabinetit qeveritar, përfshirë ngritjen e pagës së Kryeministrit, zëvendës kryeministrave, ministrave, këshilltarëve, dhe një kategorie të shërbyesve civilë. Përmes këtij vendimi, pothuajse janë dyfishuar pagat e pozitave të lartë-përmendura. Paga e Kryeministrit të Kosovës, është ngritur në 2950 euro, përderisa paga e Zëvendëskryeministrave është ngritur në 2500 euro. Pagat e Ministrave me këtë vendim janë ngritur në 2000 euro.

Për më tepër, Vendimi i Qeverisë, tejkalon kompetencat e përcaktuara me Ligj dhe me Rregulloren e Punës së Qeverisë, e cila në asnjë dispozitë të saj nuk përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e Qeverisë për caktimin e pagave apo kompensimit për Kryeministrin apo ministrat.

Në bazë të Kushtetutës dhe ligjit të aplikueshëm në Kosovë, kompetentë për të vendosur lidhur me pagat e funksionarëve të lartë publik në Kosovë, veçanërisht për pozitën e Kryeministrit dhe ministrave është Kuvendi i Kosovës. Prandaj, ky vendim është i kundërligjshëm dhe ndërhyrje arbitrare e drejtpërdrejtë në kompetencat e Kuvendit të Kosovës.

Vendimi i miratuar nga Qeveria Haradinaj, përveç që është bërë në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm, i njëjti është bërë pa analizë ligjore adekuate dhe pa vlerësim apo konsultim lidhur me ndikimin financiar që ky vendim ngërthen në vete për buxhetin e pushtetit ekzekutiv dhe pushtetin gjyqësor. Për më tepër, Vendimi lidhur me ngritjen e pagave bie në kundërshtim me Kodin Penal të Kosovës, respektivisht nenin 424, i cili përcakton situatat e konfliktit të interesit në rastet kur zyrtarët e lartë shtetërorë marrin pjesë personalisht në ndonjë çështje zyrtare në të cilën ai apo ndonjë anëtar i familjes ose ndonjë person juridik që ka të bëjë me të ka interes financiar.

Kuvendi i Kosovës gjatë vitit 2010, kishte miratuar Ligjin për Gjykatat dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit, duke ndërtuar standardin e nivelizimit të pagave për gjykatës dhe prokurorë me pagat në ekzekutivin e vendit, respektivisht pagat e Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurorit të Shtetit ishin barazuar me pagën e Kryeministrit të vendit.

Duke marr për bazë numrin aktual dhe numrin e pozitave të lejuara për gjykatës dhe prokurorë, dhe pozitave tjera në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, pagat e të cilave janë të lidhura drejtpërdrejtë me pagat e kabinetit qeveritar, numri kalon 650 pozita, që brenda një viti kalendarik ka ndikim të madh financiar që mund të llogaritet në disa miliona euro.

Vendimi i Qeverisë së Kosovës, ka ngritur shqetësime edhe lidhur me faktin, se Qeveria, nuk ka dhënë sqarime nëse një vendim i tillë, do të zbatohet edhe në raport me sistemin gjyqësor dhe prokurorial, marr për bazë obligimet ligjore që dalin nga neni 29 i Ligjit për Gjykatat dhe neni 21 i Ligjit për Prokurorin e Shtetit.

Heshtja e Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës, lidhur me sigurinë juridike për gjykatës dhe prokurorë, si pasojë e vendimit të qeverisë lidhur me ngritjen e pagave për kabinetin qeveritar, në praktikë cenonë rëndë pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Për më tepër, një qasje e tillë, bie në kundërshtim me praktikën dhe standardet ndërkombëtare, pjesë e të cilave është edhe vet Republika e Kosovës. IKD rikujton se pagat dhe kompensimi i gjykatësve dhe prokurorëve janë kategori ligjore dhe për të njëjtat nuk mund të krijohen praktika të kundërligjshme nga pushteti ekzekutiv, ku rritja e të ardhurave të gjykatësve dhe prokurorëve, bazohet në vullnetin e ekzekutivit, përmes vendimeve ad hoc.

IKD rekomandon Qeverinë Haradinaj që të anulohet urgjentisht vendimin e kundërligjshëm për rritjen e pagave të pushtetit ekzekutiv. Gjithashtu, rekomandon hartimin dhe miratimin e Ligjit për Pagat e Funkionarëve të Lartë të Shtetit, i cili duhet të reflektojë standardin e ndërtuar në Kushtetutë për barazinë e pushteteve dhe ofrimin e sigurisë juridike për bartësit e funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale. IKD rekomandon Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial, që të zbatojnë obligimet kushtetuese dhe ligjore për të mbrojtur barazinë e pushteteve, duke garantuar respektim të parimeve të sundimit të ligjit dhe jo-nënshtrim ndaj pushteteve tjera.

IKD rekomandon organet e ndjekjes që në pajtim me obligimet kushtetuese dhe ligjore të ndërmarrin veprime ligjore për të hetuar vendimin e kundërligjshëm të Qeverisë Haradinaj.

II. Vendimi i kundërligjshëm i Qeverisë Haradinaj për rritjen e pagave të pushtetit ekzekutiv

Qeveria e Kosovës më 20 dhjetor 2017, kishte miratuar një varg vendimesh, duke përfshirë Vendimin lidhur me miratimin e Raportit 100 ditor të Punës së Qeverisë së Kosovës. Ky raport përmbledh rezultatet e punës së Qeverisë Haradinaj gjatë 100 ditëve të para. Krahas miratimit të këtij vendimi, Qeveria Haradinaj po me këtë datë ka miratuar edhe një vendim për ngritjen e mirëqenies ekonomike të një kategorie të pozitive të kabinetit qeveritar, përfshirë ngritjen e pagës së Kryeministrit, zëvendës kryeministrave, ministrave, këshilltarëve, dhe një kategorie të shërbyesve civilë.

Qeveria përmes Vendimit 4/20 të miratuar më 20 dhjetor 2017, pothuajse ka dyfishuar pagat e pozitive të lartë-përmendura. Sipas këtij vendimi, paga e Kryeministrit të Kosovës, është ngritur në 2950 euro, përderisa paga e Zëvendëskryeministrave është ngritur në 2500 euro. Pagat e Ministrave me këtë vendim janë ngritur në 2000 euro.¹

Në bazë të Kushtetutës dhe ligjit të aplikueshëm në Kosovë, kompetentë për të vendosur lidhur me pagat e funksionarëve të lartë publik në Kosovë, veçanërisht për pozitën e Kryeministrit dhe ministrave është Kuvendi i Kosovës.

Në pajtim me këtë mandat, Qeveria e Kosovës gjatë vitit 2012, kishte iniciuar projektligjin për Pagat e Funksionarëve Publik, qëllimi i së cilës ishte përcaktimi i nivelit të pagës bazë, dhe rregullat për shtesa dhe kompensime të tjera për funksionarët publikë. Sipas këtij projektligji ishin propozuar edhe koeficientet për çdo pozitë të lartë publike, si të Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, pozitive në gjyqësor, prokurori, polici, dhe pozita tjera të larta në Republikën e Kosovës. Projekt-ligji i tillë do të duhet të dërgohej në Kuvend për shqyrtim dhe miratim, gjë që nuk ka ndodhur asnjëherë.²

Vendimi i miratuar nga Qeveria Haradinaj, përveç që është bërë në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm, i njëjti është bërë pa analizë ligjore adekuate dhe pa vlerësim apo konsultim lidhur me ndikimin financiar që ky vendim ngërthen në vete për buxhetin e pushtetit ekzekutiv dhe pushtetin gjyqësor. Për më tepër, Vendimi lidhur me ngritjen e pagave bie në kundërshtim me Kodin Penal të Kosovës, respektivisht nenin 424, i cili përcakton situatat e konfliktit të interesit në rastet kur zyrtarët e lartë shtetërorë marrin pjesë personalisht në ndonjë çështje zyrtare në të cilën ai apo ndonjë anëtar i familjes ose ndonjë person juridik që ka të bëjë me të ka interes financiar.³

¹ Vendimet e Qeverisë të miratuara me 20 dhjetor 2017. Shih në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_mbledhjes_se_20.pdf

² Projekt-Ligji për Pagat e Funksionarëve Publik, në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Projektligji_per_Pagat_e_Funksionareve_Publik.pdf

³Neni 424 i Kodit Penal të Kosovës, përcakton se: 1.Personi zyrtar i cili merr pjesë personalisht në ndonjë çështje zyrtare në të cilën ai apo ndonjë anëtar i familjes ose ndonjë person juridik që ka të bëjë me të ka interes financiar,

Vendimi i Qeverisë Haradinaj bie në kundërshtim edhe me vet politikat e kësaj Qeverie, lidhur me plotësimin e kriterëve të miratuara nga po kjo qeveri dhe Kuvendi i Kosovës, lidhur me Reformën e Agjendës Evropiane.

Përderisa Kosova në vitin 2015 kishte nënshkruar Marrëveshjen për Stabilizim Asocim me Bashkimin Evropian, në nëntor të vitit 2016, Kosova dhe Bashkimi Evropian kishin filluar dialogun lidhur me Reformën e Agjendës Evropiane ku ishin paraparë 22 prioritete dhe 130 veprime që Kosova duhej t'i plotësonte në rrugën drejt integritit evropian. Reforma e Agjendës Evropiane ishte miratuar në Kuvendin e Kosovës. Një ndër prioritetet e Kosovës për plotësimin e këtyre kriterëve ishte edhe plotësim ndryshimi i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Plotësim ndryshimi i projektligjit ishte kërkesë e Bashkimit Evropian në fushat që kanë të bëjnë me kategorizimin e qartë të zyrtarëve publik në ligj, përcaktimi në mënyrë të qartë të aktiviteteve që zyrtarët e lartë publik lejohen apo nuk lejohen që t'i ushtrojnë gjatë kohës që ushtrojnë funksionin publik, përfshirë aktivitetet dhe situatat që ish-zyrtarët e lartë publik i kanë të ndaluara t'i ushtrojnë pas përfundimit të mandatit të tyre zyrtar.

Sipas kërkesave të Bashkimit Evropian ligji duhet të qartësoj obligimet e zyrtarëve publik dhe mbikëqyrësve të tyre në situatat e konfliktit të interesit, përfshirë përcaktimin dhe fillimin e procedurave në rastet e konfliktit të interesit.

Vendimi i Qeverisë Haradinaj bie në kundërshtim me vet qëllimin e Projekt-Ligjit mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik të miratuar nga vet Qeveria Haradinaj dhe i cili ligj është dërguar në Kuvendin e Kosovës. Neni 1 i këtij ligji përcakton se *“qëllimi i këtij ligji është forcimi i integritetit të sektorit publik dhe garantimi i kryerjes së detyrave publike në mënyrë objektive, të paanshme dhe transparente në shërbim të interesit publik nëpërmjet identifikimit, parandalimit, menaxhimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave të zyrtarëve.”*⁴

Për më tepër, Vendimi i Qeverisë, tejkalon kompetencat e përcaktuara me Ligj dhe me Rregulloren e Punës së Qeverisë, e cila në asnjë dispozitë të saj nuk përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e Qeverisë për caktimin e pagave apo kompensimit për Kryeministrin apo ministrat.⁵

dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet. 2. Nëse çështja zyrtare është veprim i prokurimit apo ankand publik, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet. 3. Për qëllime të këtij neni, shprehja “merr pjesë” nënkupton ushtrimin e autoritetit zyrtar përmes vendimit, miratimit, mosmiratimit, rekomandimit, këshillimit, hetimit ose në ndonjë mënyrë tjetër të ushtrimit të ndikimit për një çështje zyrtare.

⁴ Neni 1 i Projekt-Ligjit mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik.

⁵ Rregullore e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës. Shih në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/RREGULLORE_E_PUNES_SE_QEVERISE_SE_REPUBLIKES_SE_KOSOVES_NR_09_2011.pdf

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Rregullorja e Punës së Kuvendit kanë përcaktuar se kompetent për miratimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës është vet Kuvendi i Kosovës, andaj çdo veprim i Qeverisë, lidhur me pagat dhe kompensimin e Kryeministrit dhe kabinetit qeveritar, përmes vendimeve, hyn në kuadër të vendimeve arbitrare, që cenojnë rëndë integritetin e ekzekutivit të vendit dhe parimet bazë të qeverisjes së mirë.

III. Ndikimi financiar i Vendimit të Qeverisë Haradinaj në sistemin gjyqësor dhe prokurorial

Kuvendi i Kosovës gjatë vitit 2010, kishte miratuar Ligjin për Gjykatat dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit. Përderisa, këto ligje në parim kishin hyrë në fuqi me 1 janar 2013, neni 29 i Ligjit mbi Gjykatat lidhur me pagat dhe kompensimin gjyqësor⁶ dhe neni 21 i Ligjit për Prokurorin e Shtetit⁷ kishin hyrë në fuqi më 1 janar 2011. Me këto dy ligje, Kuvendi i Kosovës, kishte ndërtuar standardin e nivelizimit të pagave për gjykatës dhe prokurorë me pagat në ekzekutivin e vendit, respektivisht pagat e Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurorit të Shtetit ishin barazuar me pagën e Kryeministrit të vendit.⁸

Përmes një ligji të tillë, për herë të parë gjykatësit dhe prokurorët e shtetit, kompensoheshin me një pagë dinjitoze nga shteti i Kosovës lidhur me punën dhe përgjegjësitë e tyre kushtetuese dhe ligjore.

Neni 29 i Ligjit për Gjykatat përcakton se gjatë mandatit të tyre në detyrë gjyqtarët do të pranojnë pagat si në vijim:

- 1.1. Kryetari i Gjykatës Supreme do të pranojë një pagë ekuivalente me atë të Kryeministrit të Republikës së Kosovës.
- 1.2. të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Supreme do të pranojnë një pagë ekuivalente me atë të një ministri në Qeveri.
- 1.3. Kryetari i Gjykatës së Apelit do të pranojë një pagë ekuivalente me atë të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës.
- 1.4. të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Apelit do të pranojnë një pagë ekuivalente prej nëntëdhjetë (90) % të Kryetarit të Gjykatës së Apelit.
- 1.5. Kryetari i Gjykatës Themelore do të pranojë një pagë ekuivalente me atë të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit.

⁶ Neni 29 i Ligjit për Gjykatat, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2700>

⁷ Neni 21 i Ligjit për Prokurorin e Shtetit, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2710>

⁸ Adem Gashi dhe Betim Musliu, Reforma e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë, Instituti i Kosovës për Drejtësi, dhjetor 2013. Shih në: http://kli-ks.org/ep-content/uploads/2015/05/Reforma-e-sistemit-te-drejtisesise_IKD_shqip.pdf

1.6. gjyqtari mbikëqyrës i një dege të Gjykatës themelore do të pranojë një pagë ekuivalente me nëntëdhjetepesë (95) % të Kryetarit të Gjykatës Themelore;

1.7. çdo gjyqtar i Gjykatës Themelore do të pranojë një pagë bazë jo më pak se shtatëdhjetë (70)% të pagës së Kryetarit të Gjykatës Themelore. Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të shpallë një plan për kompensime shtesë të cilat njohin përgjegjësinë unike të gjyqtarëve të cilët shërbejnë në departamentet për krimet e rënda, Çështjet Ekonomike apo Administrative; por shumica e pagës bazë dhe kompensimeve shtesë në asnjë rast nuk do të tejkalojë nëntëdhjetë (90) % të pagës së Kryetarit të Gjykatës Themelore.

Ndërkaq, me plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Gjykatat në qershor të vitit 2015, është përcaktuar se “Gjyqtari i Gjykatës Supreme do të pranojë pagën në shkallë prej nëntëdhjetë për qind (90%) të pagës së Kryetarit të Gjykatës Supreme”.

Edhe neni 21 i Ligjit për Prokurorin e Shtetit përcakton pagën dhe kompensimin për prokurorë në mënyrë ekuivalente sikurse pagat dhe kompensimin për gjykatës duke marr për bazë shkallësh-mërinë në Prokurorin e Shtetit.

Aktualisht në Gjykatat e Kosovës, funksionin e gjykatësit e ushtrojnë rreth 400 gjykatës, përderisa në Kosovë aktualisht janë afërsisht 180 prokurorë, pa përfshirë edhe mbi 60 pozita për gjykatës dhe prokurorë që janë në proces të rekrutimit dhe të cilët pritet të fillojnë punën gjatë fillimit të vitit 2018.

Në kuadër të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, ekzistojnë edhe një varg pozitash menaxheriale ku pagat dhe kompensimi është përcaktuar apo nivelizuar me pozita të gjyqtarëve të apelit apo gjykatave tjera, që në praktikë shton numrin e pozitave apo personave të cilëve iu janë rritur të pagat në mënyrë automatike sipas vendimit të Qeverisë Haradinaj.

Duke marr për bazë numrin e pozitave të lejuara për gjykatës dhe prokurorë, dhe pozitave tjera në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, pagat e të cilave janë të lidhura drejtpërdrejtë me pagat e kabinetit qeveritar, numri kalon 650 pozita, që brenda një viti kalendarik ka ndikim të madh financiar që mund të llogaritet në disa miliona euro.

Vendimi i Qeverisë së Kosovës, ka ngritur shqetësime edhe lidhur me faktin, se Qeveria, nuk ka dhënë sqarime nëse një vendim i tillë, do të zbatohet edhe në raport me sistemin gjyqësor dhe prokurorial, marr për bazë obligimet ligjore që dalin nga neni 29 i Ligjit për Gjykatat dhe neni 21 i Ligjit për Prokurorin e Shtetit.

Heshtja e Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës, lidhur me sigurinë juridike për gjykatës dhe prokurorë, si pasojë e vendimit të qeverisë lidhur me ngritjen e pagave për kabinetin qeveritar, në praktikë cenon rëndë pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Për më tepër, një qasje e tillë, bie në kundërshtim me praktikat dhe standardet ndërkombëtare, pjesë e të cilave është edhe vet Republika e Kosovës. Lidhur me këtë, Komisioni i Venecias ndan mendimin se pagat për gjykatës duhet të korrespondojnë më dinjitetin e profesionit të gjykatësit dhe se paga adekuate është e një rëndësie të veçantë për të mbrojtur gjykatësin nga ndikimi i jashtëm. Niveli i pagës duhet të vendoset në bazë të kushteve sociale, duke krahasuar nivelin e **pagave të zyrtarëve më të lartë**. Caktimi i pagës duhet të bazohet në një standard të përgjithshëm dhe të përcaktohet në kriteret objektive dhe transparente, dhe assesi në performancën individuale të gjykatësit. Bonuset apo shtesat përfshin elemente të diskrecionit dhe duhet të përjashtohen.

Qëndrim pothuajse të njëjtë lidhur me pagat e gjykatësve mban edhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara në komentin nr. 32, që ndërlidhet me zbatimin e nenit 14 të Konventës për të Drejtat Politike dhe Civile e aplikueshme drejtpërdrejtë në Kosovë. Këshilli i Ministrave të Këshillit të Evropës mban qëndrim të njëjtë përmes rekomandimit nr. R(94) 12, Parimi III, para, 1b. Po ashtu neni 13 i Kartës Universale të Gjykatësve përcakton se gjykatësit duhet të pranojnë pagesë të mjaftueshme për të siguruar pavarësi të vërtetë ekonomike. Paga nuk duhet të bazohet në rezultate të gjykatësit, dhe nuk guxon të zvogëlohet gjatë shërbimit të tij. Përderisa, mbrojtja e pavarësisë së gjykatësve është e garantuar edhe me Kushtetutë, siç është rasti i nenit 3, seksionit i Kushtetutës së SHBA—ve që përmban ndalesë të drejtpërdrejtë për zvogëlimin e pagesës së gjykatësit gjatë ushtrimit të funksionit të tij. Natyrisht, zvogëlimi i pagës së gjykatësve ose prokurorëve mund të bëhet vetëm atëherë kur ndaj tyre shqiptohen masa disiplinore nga mekanizmat e brendshëm të llogaridhënies.

Vendimi i Qeverisë në rastin konkret tejkalon Kuvendin e Kosovës, duke marr kompetenca dhe përgjegjësi që me ligj i takojnë legjislativit, në rastin konkret Kuvendit të Kosovës. Përkundrazi një vendim i tillë, dhe pa ndarë buxhet për sistemin gjyqësor dhe prokurorial për nivelizim të pagave me kabinetin qeveritar, shkel standardin që e kishte ndërtuar Kuvendi i Kosovës në vitin 2010, lidhur me nivelizimin e gjykatësve dhe prokurorëve njëjtë me ekzekutivin.

IKD vlerëson se kompensimi dhe stimulimi i gjykatësve dhe prokurorëve, assesi nuk guxon të varet prej pushtetit ekzekutiv në formë të vendimeve ad hoc. Kjo formë krijon drejtpërdrejtë pasiguri juridike për pagat e gjykatësve dhe prokurorëve, ndikim dhe cenim të pavarësisë së tyre në ushtrimin e pavarur, të paanshëm dhe në mënyrë profesionale të funksionit të tyre të shenjtë.

IKD rikujton se pagat dhe kompensimi i gjykatësve dhe prokurorëve janë kategori ligjore dhe për të njëjtat nuk mund të krijohen praktika të kundërligjshme nga pushteti ekzekutiv, ku rritja e të ardhurave të gjykatësve dhe prokurorëve, bazohet në vullnetin e ekzekutivit, përmes vendimeve ad hoc.

IKD siç ka shprehur vazhdimisht përkrahjen për gjykatësit dhe prokurorët, kërkon që mbështetja e tyre financiare të rritet sa më shumë brenda mundësive të Buxhetit të Republikës së Kosovës,

por kërkon që kjo të bëhet ekskluzivisht përmes ndryshimeve dhe plotësimeve ligjore dhe assesi përmes vendimeve ad-hoc të pushtetit ekzekutiv.

Në të gjitha vendet demokratike, shtetet që kanë krijuar legjislacionin që rregullon fushën e sistemit të drejtësisë, bazuar edhe në standardet ndërkombëtare, gjykatësit dhe prokurorët i trajtojnë në mënyrë të barabartë me pozitat e larta publike në një shtet që synon sundimin e ligjit. Prandaj, IKD konsideron se përmes këtij vendimi selektiv, krijohet pabarazi dhe diskriminim i gjykatësve dhe prokurorëve, të cilët sërish do të jenë të pabarabartë me pushtetin ekzekutiv në kundërshtim me parimet e vendosura dhe garancitë ligjore dhe standardet ndërkombëtare.

IKD përfundimisht i bën thirrje Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës që të trajtojë seriozisht barazinë e pushtetit gjyqësor me vetën e tyre, njëjtë sikurse garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Në këtë drejtim, kërkon që të finalizohet sa më parë Projektligji për Pagat e Funkionarëve Publik, në të cilin do duhej të rregullohej konglomerati me pagat në të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës. Në kuadër të këtij ligji, duhet të rregullohet edhe çështja e pagave të bartësve të funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale, i cili duhet të bëhet në mënyrë meritore, bazuar në parimet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës për barazinë e pushteteve.

IKD gjithashtu rikujton se pushteti ekzekutiv përmes këtij projektligji ishte përpjekur të degradonte pushtetin gjyqësor, duke ulur pagat ndjeshëm në krahasim me dy pushtetet tjera. Në vitin 2011, me hyrjen në fuqi të dispozitave të caktuara të Ligjit për Gjykata dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit, ishte mundësuar nivelizimi i pagave të gjykatësve dhe prokurorëve me ato të ekzekutivit, duke shënuar një hap të madh drejt barazisë të pushteteve dhe jetësimit të ndarjes së pushteteve ashtu siç garanton Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim, projektligji për pagat e funksionarëve publik duhet të përpilohet sa më parë dhe të shënojë progres në avancimin e pozitës së gjykatësve dhe prokurorëve, duke krijuar balancë ndërmjet pushteteve në Kosovë.

Krejt në fund, IKD vazhdimisht ka pranuar ankesa dhe pakënaqësi të shumë punonjësve brenda sistemit gjyqësor dhe prokurorial për trajtim të pabarabartë të të punësuarve, të cilët kryejnë përgjegjësi të njëjta, por që kanë koeficiente të ndryshëm. Ky diskriminim është vërejtur edhe brenda këtyre sistemeve edhe në mes të të punësuarve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial. IKD fton Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial që brenda kompetencave të tyre ligjore të ndërmarrin veprime konkrete në drejtim të krijimit të një sistemi, i cili mundëson qasje të barabartë për të gjithë të punësuarit, duke i trajtuar në mënyrë meritore dhe jo-diskriminuese.

IV. Rekomandime

- IKD rekomandon Qeverinë Haradinaj që të anuloj urgjentisht vendimin e kundërligjshëm për rritjen e pagave të pushtetit ekzekutiv.
- IKD rekomandon hartimin dhe miratimin e Ligjit për Pagat e Funkionarëve të Lartë të Shtetit, i cili duhet të reflektojë standardin e ndërtuar në Kushtetutë për barazinë e pushteteve dhe ofrimin e sigurisë juridike për bartësit e funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale.
- IKD rekomandon Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial, që të zbatojnë obligimet kushtetuese dhe ligjore për të mbrojtur barazinë e pushteteve, duke garantuar respektim të parimeve të sundimit të ligjit dhe jo-nënshtrim ndaj pushteteve tjera.
- IKD rekomandon organet e ndjekjes që në pajtim me obligimet kushtetuese dhe ligjore të ndërmarrin veprime ligjore për të hetuar vendimin e kundërligjshëm të Qeverisë Haradinaj.